REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 nëntor 2026
Nr. ref.:AGJ 3251/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI187/26

Parashtrues

Ajshe Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën [C.nr.770/19] në Gjykatën Themelore në Gjakovë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ajshe Gashi, me vendbanim në fshatin Qypevë, komuna e Klinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), e përfaqësuar nga Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës në lëndën [C. nr. 770/19] në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën [C. nr. 770/19] e cila është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore, me pretendimin se kjo cenon nenin 31 [E Drejta e Gjykimit të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 korrik 2026, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën e saj përmes postës elektronike, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) e regjistroi më 6 korrik 2026.

6. Më 14 korrik 2026, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [nr. GJR. KI187/26], e caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi, gjyqtar raportues, dhe përmes Vendimit [nr. KSH. KI187/26], e caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci, anëtarë.

7. Më 22 korrik 2026, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 4 gusht 2026, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi informata shtesë përkitazi me statusin e lëndës [C. nr. 770/19] dhe veprimeve të ndërmarra lidhur me rastin.

9. Më 11 gusht 2026, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë informatat përkitazi me lëndën [C. nr. 770/19].

10. Më 4 nëntor 2026, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata vendosi: (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 4 qershor 2001, kishte shpërthyer një zjarr në shtëpinë e banimit të parashtrueses së kërkesës dhe bashkëshortit të saj të ndjerë, D.D.

12. Më 6 qershor 2001, Gjykata Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale), sipas propozimit të të ndjerit D.D., përmes procesverbalit [Ndr.45/2001] konstatoi sigurimin e provave nga shikimi i vendit të ngjarjes si dhe caktoi ekspertin e ndërtimtarisë B.N. për hartimin e ekspertizës lidhur me vlerën e dëmit të shkaktuar si rezultat i zjarrit. Më 11 qershor 2001, eksperti i ndërtimtarisë B. N. dorëzoi ekspertizën e kërkuar nga Gjykata Komunale.

Procedura gjyqësore lidhur me padinë

13. Më 15 qershor 2001, i ndjeri D. D., parashtroi padi në Gjykatën Komunale kundër Korporatës Energjetike të Kosovës, Distribucioni në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: KEK) për kompensim të dëmit të objektit të shtëpisë së djegur në shumën prej 12,389.62€ (dymbëdhjetëmijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë euro).

14. Më 22 janar 2002, eksperti financiar, H. B., dorëzoi ekspertizën financiare përkitazi me dëmin e mobileve dhe pajisjeve shtëpiake, ndërsa, në një datë të pacaktuar, eksperti i inxhinierisë, R. H., dorëzoi ekspertizën lidhur me shkaktarin e paraqitjes së zjarrit.

15. Në dhjetor 2002, Ekspertët e Fakultetit Elektroteknik-Prishtinë, dorëzuan superekspertizën lidhur me shkaktarin e zjarrit.

16. Më 18 prill 2003, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [C. nr. 246/2001] aprovoi kërkesëpadinë e të ndjerit D. D. dhe detyroi KEK-un, që në emër të kompensimit për dëmet e shkaktuara nga zjarri, t'ia paguaj shumën prej 12,389.00€ (dymbëdhjetëmijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë euro), si dhe në emër të pajisjeve shtëpiake dhe mobilimit të brendshëm, shumën prej 3,550.00€ (tremijë e pesëqind e pesëdhjetë euro), apo shumën e tërësishme prej 16,183.00€ (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre euro), si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1,190.00€ (njëmijë e njëqind e nëntëdhjetë euro), me kamatë 3% (tre përqind) nga dita e përpilimit të ekspertizave.

17. Më 29 maj 2003, KEK parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë, kundër Aktgjykimit [C. nr. 246/2001] të 18 prillit 2003 të Gjykatës Komunale, të cilën ankesë e plotësuan më 11 qershor 2003, me propozimin që të refuzohet padia e paditësit si e pabazuar.

18. Më 22 shkurt 2005, Gjykata e Qarkut në Pejë, përmes Aktvendimit [c. nr. 245/2003], prishi Aktgjykimin [C. nr. 246/2001] e 18 prillit 2003 të Gjykatës Komunale, dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

19. Më 29 nëntor 2006, i ndjeri D.D. dorëzoi parashtresë përkitazi me kërkesën e gjykatës për dorëzimin e adresave të fqinjëve dëshmitarë të rastit.

20. Më 16 gusht 2006, KEK dorëzoi parashtresë në Gjykatën Komunale, duke ritheksuar se e konteston padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar, duke theksuar se nuk mban përgjegjësi për rastin e ndodhur, me arsyetimin se shkak eventual i shkrirjes së kabullit është: *"[...] vetëm e vetëm mbingarkesa e elementeve harxhuese brenda shtëpisë"*.

21. Më 25 prill 2013, është mbajtur seanca përgatitore lidhur me padinë e lartcekur.

22. Më 30 prill 2013, i ndjeri D.D. dorëzoi në Gjykatën Themelore propozim për dëshmitarë.

23. Më 12 maj 2014, i ndjeri D.D. dorëzoi në Gjykatën Themelore urgjencë-lutje për caktimin e seancës shqyrtuese.

24. Më 5 qershor 2014, i ndjeri D.D. dorëzoi në Gjykatën Themelore parashtresë për trajtim me urgjencë të rastit, përkatësisht caktimin e seancës, duke theksuar se i njëjti është i sëmurë dhe në gjendje të rëndë shëndetësore.

25. Më 22 gusht 2017, D.D. ndërroi jetë.

26. Më 30 tetor 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C. nr. 225/05] ndërpreu procedurën si rezultat i vdekjes së paditësit D.D.

27. Më 8 tetor 2019, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore kërkesën për vazhdimin e procedurës civile e cila ishte ndërprerë si rezultat i vdekjes së bashkëshortit të saj, në cilësi të trashëgimtares së vetme ligjore të të ndjerit D. D.

28. Më 20 shkurt 2024, Gjykata Themelore përmes procesverbalit [C. nr. 770/19] konstatoi se nuk mbahet seanca përgatitore si rezultat i mungesës së palës së paditur - KEK, me arsyetimin se nuk ka prova që të njëjtës i është dorëzuar ftesa në mënyrë të rregullt.

29. Më 25 mars 2024, Gjykata Themelore mbajti seancë, e cila përmes Aktvendimit [C. nr. 770/19] aprovoi vazhdimin e procedurës së ndërprerë përmes Aktvendimit [C. nr. 225/05] të 30 tetorit 2017, duke e njohur legjitimitetin e parashtrueses së kërkesës, si dhe pas mbajtjes së seancës konstatoi se: (i) aprovohet propozimi i parashtrueses së kërkesës, që gjykata t'i drejtohet shërbimit Meteorologjik të Kosovës lidhur me të dhënat meteorologjike në orët e hershme të mëngjesit të 4 qershorit 2001 në Gjakovë; (ii) aprovohet propozimi i parashtrueses së kërkesës që në shqyrtimin kryesor të ftohen për t'u deklaruar eksperti i elektroteknikës dhe eksperti i ndërtimtarisë.

30. Më 11 prill 2024, Gjykata Themelore kërkoi nga Instituti Meteorologjik i Kosovës raport për të dhënat meteorologjike në ditën e ndodhjes së avarisë së zjarrit.

31. Më 23 prill 2024, Gjykata Themelore mbajti seancën kryesore.

32. Më 21 maj 2024, Gjykata Themelore mbajti vazhdimin e seancës kryesore, e cila përmes procesverbalit [C. nr. 770/19] konstatoi se: (i) u lexua ekspertiza e ndërtimtarisë së 11 qershorit 2001 nga eksperti B. N., i cili në deklarimin e tij qëndroi pas vlerësimit të dhënë, duke argumentuar se vlerësimi i mobilieve dhe pajisjeve shtëpiake është bërë sipas vlerës së tregut për kohën kur është hartuar ekspertiza, bazuar në metodën krahasuese; (ii) përmes e-mailit zyrtar do t'i drejtohet Agjencisë Meteorologjike të Kosovës me kërkesën për të dhënat meteorologjike në ditën e djegies së shtëpisë; (iii) sipas detyrës zyrtare do t'i drejtohet KEDS në Prishtinë, për dorëzimin e një raporti të tensionit, përkitazi me njehsorin elektrik "*ISKRA*" numër 1306866, në adresën e shtëpisë së djegur, ditën respektive; dhe (iv) seanca e sotme shtyhet deri në pranimin e raporteve të kërkuara.

33. Në të njëjtën ditë, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C. nr. 770/19] caktoi ekspertin A. B., dhe kërkoi që i njëjti të dorëzojë ekspertizën financiare përkitazi me vërtetësinë e lartësisë së çmimeve të gjësendeve të dëmtuara, si rezultat i ndërrimit të jetës së hartuesit të ekspertizës financiare H. B. dhe pamundësisë së pjesëmarrjes së të njëjtit në seancën shqyrtuese.

34. Më 18 tetor 2024, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C. nr. 770/19] në vend të ekspertit A. B. caktoi eksperten A.Q-B., që të dorëzojë ekspertizën përkitazi me vërtetësinë e lartësisë së çmimeve të gjësendeve të dëmtuara.

35. Më 30 tetor 2024, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore parashtresën përkitazi me kërkesën për ndryshimin e mbiemrit të parashtrueses së kërkesës, si rezultat i rimartesës, duke dorëzuar ekstraktin e lindjes dhe dokumentet personale për vërtetimin e gjendjes së saj civile.

36. Më 15 dhe 24 qershor 2026, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore, parashtresë për precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë.

37. Më 3 korrik 2026, Gjykata Themelore mbajti vazhdimin e seancës së shqyrtimit kryesor.

38. Më 27 korrik 2026, Gjykata Themelore mbajti vazhdimin e seancës së shqyrtimit kryesor në të cilën dëshmoi eksperti i elektroteknikës R. S.

39. Deri më 11 gusht 2026, kur Gjykata ka pranuar informata nga Gjykata Themelore, lënda me numër [C. nr. 770/199] ndodhej në shqyrtim në Gjykatën Themelore.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

40. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se kohëzgjatja e procedurës civile [C. nr. 770/19] në Gjykatën Themelore, cenon të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; si dhe cenon nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

41. Parashtruesja e kërkesës thekson se: *"Procedura kontestimore që ka për objekt kompensimin e dëmit material të shkaktuar nga zjarri i 04.06.2001 vazhdon të jetë e pazgjidhur përfundimisht që nga data e parashtrimit të padisë, më 15.06.2001, pra për më shumë se njëzet e pesë (25) vjet. Gjatë kësaj periudhe, lënda është kthyer së paku një herë në rigjykim (me Aktvendimin AC.nr.245/2003) të 22.02.2005 të Gjykatës së Qarkut në Pejë), ka ndryshuar numrin dhe instancën shqyrtues disa herë) C.nr.246/2001, rigjykim- C.nr.770/19), dhe është ndërprerë përkohësisht për shkak të vdekjes së paditësit origjinal, pa u finalizuar as pas rifillimit nga pasardhësja procedurale në vitin 2019".*

42. Në këtë kontekst, përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, parashtruesja e kërkesës thekson se: "*çështja ndërlidhet me përcaktimin e përgjegjësisë objektive/subjektive për dëm nga rrjeti elektrik, me disa ekspertiza teknike (elektroteknike dhe ndërtimtarie) dhe me pasardhësi procedurale të palëve; megjithatë, kompleksiteti faktik/juridik nuk arsyeton, në vetvete, një zvarritje prej më shumë se dy dekada e gjysmë".*

43. Tutje, përkitazi me sjelljen e parashtrueses së kërkesës, e njëjta thekson se ajo nuk ka ndërmarrë veprime "*dilatore*" përkundrazi, e njëjta ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme përshpejtimin e procedurës, ndërkaq përkitazi me sjelljen e autoriteteve gjyqësore thekson se: "*rikthimi i lëndës në rigjykim, ndërrimi i gjyqtarëve, si dhe periudhat e zgjatura pa veprime procedurale (2005-2017, 2019-sot) i atribuohet shtetit; […]*" .

44. Në këtë rast, parashtruesja e kërkesës pretendon se zvarritja e procedurës ka prodhuar pasiguri juridike të vazhdueshme, duke cenuar edhe pritjet legjitime për mbrojtjen e garancive kushtetuese nga neni 46 i Kushtetutës.

45. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që: të deklarojë kërkesën të pranueshme, të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (iii) të konstatojë se janë rrezikuar/shkelur pritjet legjitime të mbrojtura me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (iv) të urdhërojë Gjykatën Themelore në Gjakovë që të përfundoj procedurën C. nr. 770/19 me përparësi dhe brenda një afati të caktuar; si dhe (v) të urdhërojë Republikën e Kosovës që t'ia kompensojë parashtrueses shumën prej 4,000.00 € (katërmijë euro) për dëmin jomaterial (dhimbjet shpirtërore) të shkaktuar nga tejzgjatja e paarsyeshme e procedurës dhe pasiguria juridike, si dhe shumën prej 1,000.00 € (njëmijë euro) për shpenzimet e përfaqësimit ligjor.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. "Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/saj brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. […]. […]."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

46. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

48. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> Neni 47
> (Kërkesa individuale)
>
> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e saja individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
>
> Neni 48
> (Saktësimi i kërkesës)
>
> *"Parashtruesja e kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e saj të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*
>
> *Neni 49*
> *(Afatet)*
>
> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".*

49. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata duhet fillimisht të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, për të parashtruar kërkesë para Gjykatës. Gjykata vëren se procedurat fillestare ishin iniciuar nga bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses së kërkesës, D.D., i cili kishte ndërruar jetë më 22 gusht 2017. Lidhur me këtë, më 8 tetor 2019, parashtruesja e kërkesës kishte dorëzuar në Gjykatën Themelore parashtresë për "*vazhdimin e procedurës*

së ndërprerë", duke njoftuar Gjykatën Themelore se bazuar në dëshminë e aktit të vdekjes, parashtruesja e kërkesës, është evidentuar si e vetmja trashëgimtare e të ndjerit.

50. GJEDNJ-së ka përcaktuar se për të paraqitur kërkesë para Gjykatës një person duhet të jetë "*viktimë*" e shkeljes kushtetuese, "*direkte*" apo "*indirekte*". Në këtë kontekst, siç është konfirmuar në rastin KI211/25, parashtrues *Burbuqe Pruthi*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2025, Gjykata ia ka njohur statusin e "*viktimës*" edhe parashtrueses së kërkesës, e cila ishte në marrëdhënie bashkëshortore me paditësin e ndjerë, në procedurën kontestimore për shpronësimin e një prone. Parashtruesja e kërkesës në këtë rast kontestonte kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, me ç' rast pretendonte shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme (shih rastin e Gjykatës, KI211/25, parashtruese *Burbuqe Pruthi,* cituar më lart, paragrafi 45).

51. Gjykata ka sqaruar, rast pas rasti, që statusi i viktimës është po ashtu i ndërlidhur me natyrën e të drejtave që kontestohen para Gjykatës, përkatësisht nëse të drejtat përkatëse mund të cilësohen si të drejta të *"transferueshme*" apo jo. Për më tepër, Gjykata vëren se në ato raste kur statusi i viktimës iu ka akorduar të afërmve, duke i lejuar ata të parashtronin një kërkesë në lidhje me ankesat e tyre, përkatësisht, në kuadër të nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ mori parasysh faktin nëse parashtruesit mund të kishin interes material në bazë të efektit të drejtpërdrejtë në të drejtat e tyre monetare (shih, rastet e Gjykatës KI211/22 parashtrues: *IsmajI Ipshi, Bashkim Ipshi, Gjevdet Ipshi, Bekim Ipshi dhe Besim Ipshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 tetorit 2024, paragrafi 79; dhe rastet e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 48).

52. Në rastin konkret, padia e parashtruar nga i ndjeri D.D. kishte të bënte me zjarrin e shkaktuar në shtëpinë e banimit të parashtrueses së kërkesës dhe të ndjerit D. D. Pasi D.D. kishte ndërruar jetë, parashtruesja e kërkesës në Gjykatën Themelore parashtroi parashtresë për "*Vazhdimin e procedurës së ndërprerë*". Parashtruesja e kërkesës ia ka bashkëngjitur kërkesës edhe dëshminë e vdekjes ku ajo është evidentuar si trashëgimtarja e vetme e të ndjerit. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës ka interes të drejtpërdrejtë përkitazi me pronën kontestuese dhe si pasojë është palë e autorizuar për të paraqitur kërkesë para Gjykatës, sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe pikës 34 (1) (a) të Rregullores së punës.

53. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston kohëzgjatjen e procedurës lidhur me lëndën civile [C. nr. 770/19] pranë Gjykatës Themelore. Ajo gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit. Në lidhje me afatin për paraqitjen e kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës konteston kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore për kërkesën e saj për kompensimin e dëmshpërblimit, e cila ende nuk ka përfunduar, pasi rasti është kthyer në rigjykim në Gjykatën Themelore dhe deri më 11 gusht 2026, kur Gjykata pranoi informata nga Gjykata Themelore, ende pret të vendoset nga kjo e fundit. Gjykata, duke marrë parasysh natyrën e pretendimeve, përkatësisht kohëzgjatjen e procedurës, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kushteve të parashikuara me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kushti për paraqitjen e kërkesës brenda katër (4) muajve, pasi lënda është ende në zhvillim e sipër.

54. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

55. Gjykata rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me padinë e parashtruar më 4 qershor 2001, nga i ndjeri D.D., për kompensim të dëmit si pasojë e djegies së objektit të banimit të të ndjerit D.D. dhe parashtrueses së kërkesës. Gjykata Komunale, përmes Aktgjykimit [C. nr. 246/2001] miratoi kërkesëpadinë e bashkëshortit të parashtrueses së kërkesës, megjithatë Gjykata e Qarkut në Pejë, prishi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe lëndën e ktheu në rigjykim. Në vitin 2017, D.D. kishte ndërruar jetë, me ç' rast ishte ndërprerë procedura gjyqësore. Më 8 tetor 2019, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar kërkesën për vazhdimin e procedurës gjyqësore lidhur me padinë. Lidhur me rastin në fjalë, nga viti 2006 e deri në vitin 2026, ishte zhvilluar seanca përgatitore dhe 3 (tri) seanca të shqyrtimit kryesor, përkitazi me administrimin e provave, dëgjimin e dëshmitarëve, ricaktimin e ekspertëve dhe deklarimin e tyre. Aktualisht, lënda e parashtrueses së kërkesës [C.nr.770/19] ndodhet në rigjykim në Gjykatën Themelore, e cila sipas informatave të pranuara nga e njëjta më 11 gusht 2026, rezulton se vazhdimi i seancës kryesore shqyrtuese ishte caktuar të mbahej më 9 shtator 2026.

56. Parashtruesja e kërkesës konteston para Gjykatës kohëzgjatjen e procedurës civile në Gjykatën Themelore në Gjakovë, duke pretenduar se e njëjta cenon nenin 31 të Kushtetutës në kuptim të mungesës së vendimmarrjes në kohë të arsyeshme dhe të drejtën në pronë.

57. Andaj, Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtrueses së kërkesës në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm

58. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës, përcakton: *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme […]".*

59. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se "*Çdo person ka të drejtë që […] të dëgjohet […] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë […], e cila do të vendosë […] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij […] civile […]".*

60. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

61. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshinë, por nuk kufizohet në rastet (i) KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha,* Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović,* Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana,* Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iv) KI177/19, parashtrues *NNT "Sokoli",* Aktgjykim i 29 marsit 2021; dhe (vi) KI142/23 parashtrues *Fadil Berisha*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2025. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJEDNJ, përfshirë rastet (i) *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (iii) *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iv) *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (v) *Mikulić kundër Kroacisë,* nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; (vi) *Scordino kundër Italisë* (nr.1), [DhM] nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (vii) *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (viii) *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (ix) *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; (x) *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010; dhe (xi) *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.

62. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se (i) përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50; *Comingersoll kundër Portugalisë,* cituar më lart, paragrafi 24; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës KI06/21, cituar më lart, paragrafët 50-75; dhe KI19/21, cituar më lart, paragrafi 82; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 47).

63. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) kompleksiteti i rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Surmeli kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 128; si dhe rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 65; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 48).

64. Përkitazi me (i) kompleksitetin e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor, mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih, në mënyrë të ngjashme rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafët 66-67 KI142/23, cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastet e GJEDNJ-së, *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210).

65. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë, dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se, vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 68; dhe *Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i atribuohet autoriteteve shtetërore, dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih, rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 68-70; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 50).

66. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe sjelljet e institucioneve publike; gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor; gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmangë përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra (shih, rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafët 71-73; KI06/21, cituar më lart, paragrafi 67; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 51).

67. Sa i përket (iv) rëndësisë së e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "*sëmundje të pashërueshme*" dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*"; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull, rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih, rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 74; KI06/21, cituar më lart, paragrafi 67; dhe KI142/23, cituar më lart, paragrafi 52).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

68. Në rastin konkret, Gjykata vëren se padia kundër KEK-ut ishte parashtruar pranë Gjykatës Komunale më 15 qershor 2001. Bazuar në shkresat e lëndës, rasti është kthyer një (1) herë në rigjykim përmes Aktvendimit [Ac. nr. 245/2003] të 22 shkurtit 2005 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, dhe e njëjta vazhdoi shqyrtimin në Gjykatën Themelore edhe pas 15 qershorit 2008, kur edhe Kushtetuta hyri në fuqi. Ndërkaq procedura para Gjykatës Themelore ishte ndërprerë përmes Aktvendimit [C. nr. 225/05] të 30 tetorit 2017, si pasojë e vdekjes së D.D.-së. Në vijim, më 8 tetor 2019, parashtruesja e kërkesës, në cilësi të trashëgimtares së vetme ligjore, parashtroi kërkesë për vazhdimin e procedurës, e cila rezulton se ende është duke u shqyrtuar pranë së njëjtës instancë deri në ditën kur parashtruesja e kërkesës ka dorëzuar kërkesën e saj në Gjykatë, më 4 korrik 2026. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se periudha e cila duhet të merret parasysh për vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurës civile është 25 (njëzetë e pesë) vjet.

69. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtrueses së kërkesës, rasti i saj ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë (i) kompleksitetin e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(i) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit

70. Në rastin konkret, Gjykata vëren se padia për kompensimin e dëmshpërblimit të objektit të dëmtuar si pasojë e zjarrit dhe pajisjeve shtëpiake ndërlidhej me sigurimin e provave përmes ekspertizave të ndryshme, përfshirë: (i) ekspertizën e inxhinierisë; (ii) ekspertizën financiare; dhe (iii) ekspertizën e vlerësimit të dëmit të shkaktuar. Pas kthimit të lëndës në rigjykim po ashtu ishte kërkuar: (iv) plotësimi i ekspertizave; (v) hartimi i superekspertizës nga Fakulteti Elektroteknik në Prishtinë. Gjithashtu, lidhur me rastin (vi) ishte bërë kërkesa drejtuar Agjencisë së Shërbimit Meteorologjik për dorëzimin e raportit të motit lidhur me ditën kritike; si dhe (vii) kërkesa për deklarim të ekspertëve dhe dëshmitarëve përgjatë seancave shqyrtuese, dhe zëvendësimin e të njëjtëve, si pasojë e vdekjes së disa prej tyre përgjatë këtyre viteve.

71. Prandaj, në dritën e këtyre rrethanave, Gjykata konsideron se rasti në fjalë nuk mund të thuhet se nuk është i ndërlikuar. Megjithatë, Gjykata vlerëson se përkundër kompleksitetit, procedura në fjalë nuk përbën çështje posaçërisht të ndërlikuar, për t'u zgjidhur brenda një afati kaq të gjatë. Prandaj kompleksiteti i rastit nuk mund të shërbejë si arsyetim për mungesën e organizimit dhe mbajtjes së seancave për një periudhë prej më shumë se 25 (njëzet e pesë) vitesh.

(ii) Përkitazi me sjelljen e palës

72. Lidhur me sjelljen e palëve në procedurë, Gjykata vëren që fillimisht i ndjeri D. D., dhe më pas edhe parashtruesja e kërkesës përkitazi me procedurën civile para Gjykatës Themelore ishin aktiv me kërkesa, të cilat u parashtruan gjatë periudhës 25 prill 2013 deri më 4 korrik 2026. Respektivisht, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ishte drejtuar të njëjtës instancë, përkatësisht Gjykatës Themelore me së paku 2 (dy) kërkesa për përshpejtim të rastit.

73. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se sjellja e parashtrueses së kërkesës përkitazi me procedurën civile të kontestuar nuk mund të ketë ndikuar në tejzgjatjen e procedurave me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj. Në këtë kontekst, Gjykata, duke pasur parasysh veprimet e ndërmarra nga palët paditëse, vlerëson se palët në procedurë ishin të vëmendshëm në ndërmarrjen e hapave procedural, dhe se të njëjtit nuk ishin shkaktarë të vonesave apo shtyrjes së procedurave. Përveç periudhës nga nxjerrja e Aktvendimit të Gjykatës Themelore të 30 tetorit 2017, që ndërpreu procedurën si rezultat i vdekjes së paditësit D.D., deri më 8 tetor 2019, kur parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore kërkesën për vazhdimin e procedurës civile e cila ishte ndërprerë, në cilësi të trashëgimtares së vetme ligjore të të ndjerit D.D., periudha tjetër e kohëzgjatjes së procedurës nuk mund t'i atribuohet parashtrueses së kërkesës.

(iii) Sjellja e autoriteteve kompetente

74. Në rrethanat e rastit të tanishëm, Gjykata vëren se objekt i shqyrtimit të kësaj kërkese është procedura civile përkitazi me kompensimin e dëmit të objektit dhe pajisjeve shtëpiake të shkaktuar si pasojë e zjarrit. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se që pas kthimit të rastit në rigjykim më 22 shkurt 2005, nga shkresat e lëndës rezulton se ishin ndërmarrë disa veprime procedurale, shumica e të cilave ndërlidheshin me thirrjen e seancave, nxjerrjen dhe shqyrtimin e provave.

75. Gjykata Themelore informoi Gjykatën se lënda e parashtrueses së kërkesës është ende në pritje të vendimmarrjes nga kjo e fundit, pas kthimit tek e njëjta për rigjykim që nga viti 2005, duke shtuar se ka mbajtur seancë më 3 dhe 27 korrik 2026 në të cilën "*[...] ka bërë administrimit e provës, përkatësisht ekspertizës së elektros, si dhe ka dëgjuar ekspertin [R.S.] lidhur me ekspertizën e hartuar me shkrim. Në po këtë seancë, gjykata [Themelore] me aktvendim, ka caktuar seancën e radhës së shqyrtimit kryesor për datën 9 shtator 2026, në të cilën ka planifikuar dhe ka njoftuar palët se do të dëgjohet eksperti financiar, [A.B.].*

76. Megjithatë, Gjykata vlerëson se këto veprime nuk mund të arsyetojnë një periudhe kaq të gjatë lidhur me rastin. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata konstaton se përgjegjësia për zvarritjen kaq të gjatë të zgjidhjes së rastit konkret (përveç periudhës së ndërprerjes së procedurës përmes Aktvendimit të Gjykatës Themelore të 22 gusht 2017, që si rezultat i vdekjes së paditësit D.D., deri më 8 tetor 2019, kur parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore kërkesën për vazhdimin e procedurës civile, në cilësi të trashëgimtares së vetme ligjore të të ndjerit D.D.), i atribuohet Gjykatës Themelore. Kjo duke pasur parasysh edhe faktin se kemi të bëjmë me kërkesë për dëmshpërblim të objektit të banimit, si e drejtë esenciale e palëve për jetesë, dhe se vonesat e tilla dëmtojnë besimin e publikut në organet publike dhe posaçërisht ato të drejtësisë.

(iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor

77. Lidhur me këtë, Gjykata ka sqaruar kategoritë e caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Çështja e parashtrueses së kërkesës, jo domosdoshmërisht hyn në atë kategori.

78. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk mund të konsiderohet e arsyeshme një periudhë kaq e gjatë për zgjidhjen e një rasti të tillë pranë Gjykatës Themelore, pavarësisht natyrës së rastit. Gjykata konsideron se tejzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë, është në kundërshtim me të drejtën e parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një

afati të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.

79. Prandaj, marrë për bazë të gjitha kriteret e lartcekura, Gjykata thekson se rasti i parashtrueses së kërkesës vazhdon të jetë në shqyrtim të instancës së parë, që do të thotë se e drejta e parashtrueses së kërkesës për vendim në kohë të arsyeshme, mbetet edhe më tej e parealizuar.

80. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata nuk e sheh të nevojshme të vlerësojë ndaras pretendimin për cenim të nenit 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Përfundim lidhur me kohëzgjatjen e procedurës

81. Si përfundim, Gjykata, marrë parasysh aplikimin kumulativ të kritereve të lartcekura, konstaton se (i) megjithëse, rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me procedurë kontestimore relativisht të komplikuar, përkundër saj, procedura në fjalë nuk përbën çështje posaçërisht të ndërlikuar e cila do të mund të justifikonte që procedura gjyqësore për zgjidhjen e lëndës përkatëse të mos përfundojë as pas kaq shumë kohe; (ii) parashtruesja e kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës përmes veprimeve të saj, por vetëm ka ndjekur hapat proceduralë për realizimin e të drejtës së saj për të trashëguar pasurinë e trashëgimlënësit; ndërsa (iii) Gjykatës Themelore i janë dashur më shumë se 23 (njëzet e tri) vite, lidhur me rastin, duke mos llogaritur periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2019 kur procedura ishte ndërprerë si rezultat i vdekjes së D. D.-së; përderisa (iv) lënda e parashtrueses së kërkesës gjendet në procedurë në Gjykatën Themelore, dhe ende nuk është zgjidhur.

82. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtrueses së kërkesës, Gjykata Themelore ka shkelur të drejtën e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

83. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se, pas këtij aktgjykimi nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, gjykatat e rregullta duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmbyllur çështjen juridike të parashtrueses së kërkesës me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij aktgjykimi.

84. Gjykata gjithashtu thekson se përfundimi i lartcekur ekskluzivisht ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave sa i përket shqyrtimit të rastit të parashtrueses së kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit të tij para gjykatave të rregullta.

Përkitazi me kërkesën për kompensim dhe efektet e aktgjykimit

85. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës poshtu ka kërkuar që Republika e Kosovës t'ia kompensoj parashtrueses së kërkesës shumën prej 4,000.00€ (katërmijë euro) "*në emër të dhimbjeve shpirtërore"* si dhe shumën prej 1,000.00€ (njëmijë euro), për shpenzimet e përfaqësimit ligjor.

86. Lidhur me këtë, Gjykata ka përsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së

si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih, rastet KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafi 115; KI142/23, *Fadil Berisha* cituar më lart, paragrafi 68; dhe KI64/23, *cituar më lart*, paragrafi 104; dhe KI211/25, parashtruese *Burbuqe Prruthi,* cituar më lartë, paragrafi 77).

87. Gjykata rithekson se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të "*shpërblimit të drejtë*", sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë një dëm jomaterial. Si rrjedhojë, Gjykata në mungesë të një kompetence apo autorizimi, kërkesat e parashtruesve të kërkesave për kompensim nuk i shqyrton dhe vlerëson në procedurat para saj. Gjykata në vendimmarrjen e saj vetëm se ka nënvizuar se, në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jo-material pranë gjykatave të rregullta (shih, rastet e Gjykatës KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, cituar më lart, paragrafi 69, dhe KI211/25, parashtruese *Burbuqe Prruthi,* cituar më lartë, paragrafi 78).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 4 nëntor 2026, njëzëri:

VENDOS

I. TË SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;

III. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore në Gjakovë që jo më larg se 5 maj 2027, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese;

IV. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;

V. TË KONSTATOJË që ky aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Jeton Bytyqi	Nexhmi Rexhepi